



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2024:063446

Datë: 02.06.2025

Numri i dokumentit: 07341444

KPPP.nr. 1334/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “BAAF” SH.P.K., me numër unik identifikues 811915985, me seli në fshatin Lutogllavë, Komuna e Prizrenit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Murat Paçarada, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Mbrojtjes- Qeveria e Kosovës të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fitore Byqmeti nga Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.371/2023 të datës 07.08.2023, të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 02.06.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Ministria e Mbrojtjes- Qeveria e Kosovës ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.371/2023 i datës 07.08.2023 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha MBETET NË FUQI.



A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “BAAF” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.371/2023 të datës 07.08.2023 me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.01/2023 të datës 20.06.2023 në shumën prej 1.231.574,80€ me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën e mbetur prej 130,116.63€ (njëqind e tridhjetë mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë euro dhe gjashtëdhjetë e tre cent) me kamatë ligjore nga dita e arritur për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare, sekuestrimin, e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, ndaj urdhrit mbi lejimin e përmbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se bazuar në kontratën me numër identifikues të prokurimit 21700/022/010/111, afati kohor për dorëzim ka qenë më datë 15.12.2022, duke u bazuar në nenin 2 par 2.1 të kontratës. Më tutje debitori thekson se kontrata është nënshkruar më datë 05.07.2022 dhe nxjerrja e urdhër blerjes është bërë me datë 05.07.2022 pra afati i dorëzimit ka qenë më datë 15.12.2022 dhe sipas menaxherit të kontratës janë të paraqitura ditët e vonesave sipas liferimeve siç prezantohet në raportet e pranimit nga menaxheri i kontratës dhe komisioneve të pranimit. Më tutje ka theksuar se kreditori përkundër afatit të përcaktuar dhe të pranuar të liferimit/dorëzimit të mallrave, i njëjti nuk ka arritur që me kohë ti përmbushë obligimet e veta kontraktuale. Më tutje debitori thekson se e ka përmbushur obligimin financiar sipas kontratës ndërsa sa i përket për borxhin e papaguar, është bërë ndëshkimi për vonesat në përmbushje të kontratës nga ana e kreditorit, në bazë të nenin 16 të kontratës ashtu që me datë 18.07.2023 ka realizuar pagesën në vlerë prej 1,101,458.17€ duke ndaluar pjesën e penaltive për shkak të vonesave në vlerë prej 130,116.63€. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të shfuqizoj në tërësi urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Rushit Hoxha, me numër, P.nr.371/23, i lejuar me datë 07.08.2023.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit si të pabazuara, me arsyetimin se nuk ka qenë asnjë vonesë me përgjegjësinë e kreditorit, por për shkak të kërkesave dhe vonesave nga prodhuesi. Më tutje ka sqaruar se vonesat nuk janë krijuar me fajin e furnizuesit këtu kreditorit por për shkak të kushteve dhe rrethanave nga prodhuesi si dhe kërkesës së vetë debitorit për disa pajisje. Më tutje kreditori thekson se ka komunikuar dhe e ka njoftuar debitorin për vonesat dhe arsyet e vonesave, të cilat janë krijuar si faj i rrethanave të tjera të prodhuesit dhe kushteve të reja të krijuara në pajisjet dhe pengesat në dorëzim fizik. Më tutje ka shtuar se komunikimi, njoftimi përmes postës elektronike dhe takimet që ka pasur me përfaqësuesin e debitorit, dëshmojnë që këtë kusht të kontratës kreditori e ka përmbushur. Po ashtu ka sqaruar se debitori se me qëllim nuk e ka përmendur në tërësi nenin 16 të kontratës, sipas këtij neni nëse krijoheshin kushte për vonesat për faj të furnizuesit, autoriteti kontraktues duhet të ndërpresë kontratën, gjë që debitori nuk e ka bërë, dhe nuk e ka njoftuar me shkrim furnizuesin, por ka aprovuar zgjatje të afateve dhe as nuk ka përmendur ndonjë ndëshkim ose shkëputje të kontratës. Më tutje ka theksuar se kreditori ka njoftuar për vonesat e furnizimit pa faj të tij gjë që plotëson kushtet sipas nenit 15 të kontratës. Më tutje kreditori thekson se fatura është dokument i besueshëm dhe i njëjti është pranuar nga debitori por qëllimisht nuk është

përmbushur obligimi në tërësi. Andaj, gjykatës i propozon që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimor, P.nr.371/23, i lejuar me datë 07.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: *"Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm"*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *"Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar"*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *"Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit."*

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.371/2023 të datës 07.08.2023, bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturën me nr.01/2023 të datës 20.06.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në to janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Për më tepër, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit dhe e njëjta është pranuar nga debitori që dëshmohet përmes nënshkrimit të menaxherit të kontratës.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka aplikuar penaltitë për shkak të vonesave në dorëzimin e porosive por që gjykata vlerëson se vetë debitori ka pranuar

faturën e kreditorit me shumën e plotë të pagesës dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar, andaj nëse aplikimi i penaltive ka qenë në përputhje me kontratën apo jo nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoro, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi, ashtu që këto pretendime debitori mund të kërkoj të trajtohen në një procedurë juridiko civile.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1334/23, datë 02.06.2025

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

